



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Click Channel” Sh.P.K  
Nr. i biznesit 70811987  
Pronar – Jeton Zogjani  
OSHP “Click Channel”  
Fushë Kosovë  
Rr/ Nëna Terezë



Ref: 1309/1203/LIC/II

### VENDIM

*për licencimin e ofruesit të shërbimeve programore “Click Channel SH.P.K.” – Fushë Kosovë*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 06.07.2007. Ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 29 korrik 2013, kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore “Click Channel” Sh.P.K, ka paraqitur aplikacionin e kompletuar për Licencë të KPM-së dhe në pajtim me bazën ligjore të KPM-së.

### Arsyetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.
5. Komisioni, vlerëson se kandidati për licencë të KPM-së “Click Channel” Sh.P.K, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna e nevojshme për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullores CIMC 2007/04.


6. Komisioni, vlerëson se kandidati "Click Channel" Sh.P.K ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Informacionet e ofruara mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.
7. Në pajtim me nenin 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesi i Shërbimeve Programore "Click Channel" Sh.P.K, duhet të veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. Komisioni, vlerëson se kandidati për ofrues të shërbimeve "Click Channel" Sh.P.K ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së, në pajtim të plotë edhe me Rregulloren e KPM-së për Dhënien e Licencës (KPM-2013/04).

### VENDIM

9. Në takimin e mbajtur me datën 30 tetor 2013, Komisioni merr vendim që, ofruesit të shërbimeve programore "Click Channel" Sh.P.K, me seli në Fushë Kosovë, t'i lëshojë licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.
10. Në bazë të Nenit 3.2, të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca për "Click Channel" Sh.P.K do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
11. Në pajtueshmëri me Nenin 5.1, të Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediave audio-vizuale (KKPM-2010/02), çdo Ofrues i Shërbimeve Programore duhet të paguajë taksë vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencë të OSHP është i përcaktuar me Nenin 4.3.1. të Rregullores KKPM 2010/02.
12. Në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02, përkatësisht me nenin 5.2 të kësaj rregulloreje, Ofruesi i Shërbimeve Programore "Click Channel" Sh.P.K duhet ta paguajë taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.
13. Ofruesi i Shërbimeve Programore "Click Channel" Sh.P.K mund të fillojë transmetimin e programit vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

### Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.

  
 \_\_\_\_\_  
 Shefki Ukaj  
 Kryetar  
 Komisioni i Pavarur për Media



30 tetor 2013  
 \_\_\_\_\_  
 datë